

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6459
E hënë, 8 nëntor 2021
çmimi 0.40

Sot zyrtarisht nis fushata për balotazhin

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MARTINA SOMMER, UDHËHEQËSE E DEPARTAMENTIT PËR MIGRIM DHE INTEGRIM NË ORGANIZATËN AWO NË GJERMANI | FAQE 4-5

NË KOSOVË ËSHTË ARRITUR SHUMË, POR KA SHUMË PËR T'U BËRË



Udhëheqësja e Departamentit për Migrim dhe Integrim në Organizatën AWO në Gjermani, Martina Sommer, është shprehur e kënaqur me realizimin e projekteve të shumta në Kosovë që kanë pasur për qëllim përkrahjen e njerëzve të kthyer vullnetarisht nga Gjermania. Ajo ka treguar se për aktivitetet e kësaj organizate qytetarët e Kosovës tregojnë shumë besim. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Sommer ka deklaruar se që nga viti 2007 në Kosovë kanë ndodhur shumë gjëra pozitive. Ajo ka bërë me dije se Kosova është një vend i ri me njerëz të cilët kanë pritshmëri për të ardhmen. Në këtë intervistë Sommer ka folur edhe për projektet e reja të qendrës këshilluese të "AWO Nurnberg" në Kosovë

AKTUALE



ESCOBARI VIZITON BOSNJE-HERCEGOVINËN F. 2

BËHET THIRRJE TË NDRYSHOHET DIZAJNI I FLETËVOTIMEVE F. 6

MESIQI: KTHIMI I SERBISË NË KOSOVË ËSHTË NJË ILUZION F. 3

EKONOMI



BERZH-I: KOSOVA, E TRETA NË RAJON ME RITJEN EKONOMIKE PËR VITIN 2021 F. 7

RRITEN PËR 8.8 PËR QIND ÇMIMET E PRODHIMEVE BUJQËSORE NË KOSOVË F. 7

SPORT



GJILANI BARAZON ME PRISHTINËN, MERR POZITËN E DYTË F.10



AI STAN ATË BYLMET PAT!

Nga: Muhamet MAVRAJ

FAQE 3



KOSOVA, I VETMI SHTET NË RAJON PA VAKSINË KUNDËR HPV

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Escobari viziton Bosnje-Hercegovinën

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, njëherësh i dërguari për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pritet të arrijë më 7 nëntor në Sarajevë, në kohën e rritjes së shqetësimeve se Republika Sërpska mund të shpërbëhet nga ky vend.

Republika Sërpska së bashku me Federatën Myslimane-Kroate janë dy entitetet që përbëjnë Bosnje e Hercegovinën.

Organizimi i tillë është bërë me të ashtuquajturën Marrëveshje të Dejtonit, e cila i ka dhënë fund luftës në Bosnje në vitet 1990.

Escobar ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 5 nëntor se njerëzit në Bosnje e dinë që komuniteti ndërkombëtar është i bashkuar për t'u siguruar që "të zbatohen përkushtimet për paqe dhe siguri të njerëzve në rajon", duke shtuar se "ne jemi të përkushtuar se nuk do të ketë luftë".

Millorad Dodik, anëtar i Presidencës së Bosnjës, ka kërcënuar së fundmi me largim

të Republikës Sërpska nga institucionet kombëtare, siç është autoriteti i taksave, agjencia për ilaçe dhe nga ushtria.

Escobar ka thënë se secili motiv që dëmton Marrëveshjen e Dejtonit është "shumë destabilizues në rajon". Shtetet e Bashkuara kanë thënë edhe më parë se nuk ka "rrugë kushtetuese" për Republikën Sërpska që të tërhiqet njëanshëm nga institucionet shtetërore.

Përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar në Bosnje e Hercegovinë, Christian Schmidt, ka paralajmëruar ditë më parë se ky vend është në rrezik të menjëhershëm për t'u shpërbërë.

Në një raport për Kombet e Bashkuara, të parë nga gazeta britanike "Guardian", Schmidt ka thënë se nëse "separatistët serbë zbatojnë kërcënimet e tyre për rikrijimin e ushtrisë së tyre, duke i ndarë forcat e armatosura kombëtare në dysh", atëherë në Bosnje do të duhet të dërgohen më shumë paqeruajtëse



ndërkombëtarë për ta ndaluar rrëshqitjen e vendit drejt një lufte të re.

Detyrat paqeruajtëse ndërkombëtare në Bosnje aktualisht i ka një forcë e Bashkimit Evropian, e njohur si Eufor, që i ka rreth 700 trupa.

NATO-ja ka një seli formale në

Sarajevë.

Përfaqësuesit e Republikës Sërpska janë duke e bojkotuar punën e institucioneve qendrore të Bosnjës që nga fundi i korrikut, kur paraardhësi i Schmidt, Valentin Inzko, ka vendosur një ligj që ndalon mohimin e gjenocidit dhe

krimeve të tjera të luftës në Bosnje.

Republika Sërpska ka refuzuar ta ndalojë me ligj mohimin e gjenocidit.

Përveç Bosnjës, Escobar do të vizitojë edhe Malin e Zi.

Vizita eventuale në Kosovë nuk është konfirmuar.

Kryeministri irakian i mbijetoi sulmit me dron



BAGDAD, 7 NËNTOR - Kryeministri irakian Mustafa al-Kadhimi i ka mbijetuar një sulmi me dron në rezidencën e tij më 7 nëntor. Ky njoftim vjen në kohën e përshkallëzimit të tensioneve të lidhura me refuzimin e milicive të përkrahura nga Irani, që ta pranojnë rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të muajit të kaluar. Rezidenca e Bagdadit në Zonën e Gjellbër është goditur me sulm rakete më 7 nëntor, ka thënë zyra e kryeministrit përmes një deklarate.

Kadhimi nuk është lënduar nga sulmi, i cili në deklaratë është konsideruar "tentim-vrasje e dështuar" me dron.

Zona e Gjellbër përfshin ndërtesat e qeverisë irakiane dhe ambasadat.

Qeveria irakiane nuk ka ofruar më shumë hollësi dhe ende askush nuk e ka marrë përgjegjësinë.

Kadhimi ka bërë thirrje në "Twitter" për "qetësi dhe përmajtje nga secili, për hir të Irakut". Ai më vonë është paraqitur në një transmetim televiziv me pamje të qetë. "Sulmet me dronë dhe raketa nuk ndërtojnë atdheun dhe nuk ndërtojnë të ardhmen", ka thënë ai.

Shtetet e Bashkuara kanë dënuar sulmin. "Ne jemi qetësuar kur kemi kuptuar se kryeministri nuk është lënduar. Ky akt që duket si terrorizëm, të cilin ne e dënojmë, është drejtuar në zemër të shtetit irakian", ka thënë zëdhënësi i Departamentit

Amerikan të Shtetit, Ned Price. Qindra mbështetës të fraksioneve proiraniane në Irak kanë protestuar afër Zonës së Gjellbër për shkak të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare më 10 tetor.

Protestat janë mbajtur edhe më 6 nëntor, një ditë pasi një protestues është vrarë dhe disa të tjerë janë plagosur gjatë përlëshjeve me policinë. Ata janë parë edhe duke djegur portretin e Kadhimit, duke e cilësuar "kriminel".

Rezultatet preliminare kanë treguar se Aleanca Fatah, krah politik i rrjetit paramilitar pro Iranit, Hashed al-Shaabi, ka humbur një numër të konsiderueshëm të ulëseve në parlament.

Një gjykatë bllokoi planet e Bidenit për vaksinime nëpër kompani

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Një Gjykatë e Apelit në Shtetet e Bashkuara ka bllokuar përkohësisht planet e presidentit amerikan Joe Biden për vaksinime nëpër biznese.

Nëse shkon përpara, ligji do t'u kërkonte punëtorëve të kompanive private, me më shumë se 100 punëtorë, që të vaksinohen plotësisht kundër Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusi, apo të

testohen në baza javore.

Mirëpo gjykata ka thënë se ka hasur në çështje "statusore dhe kushtetuese" në këtë vendim, që pritej të zbatohet nga muaji janar.

Gjykata ka thënë se bllokoi mandatin dhe i ka dhënë afat administratës Biden që të përgjigjet deri të hënën, më 8 nëntor.

Pesë shtete të udhëhequra nga republikanët, Teksas, Luiziana, Misisipi, Karolina Jugore dhe

Utah, bashkë me kompani private dhe grupe fetare, kanë dorëzuar ankesat e tyre kundër planeve për vaksinim.

Ata kanë akuzuar presidentin Biden për tejkallim të autoritetit të tij.

Mesatarisht 1 100 amerikanë, shumica prej tyre të pavaksinuar, janë duke vdekur çdo ditë nga Covid-19 në ShBA. Virusi ka lënë të vdekur më shumë se 750 000 persona në këtë shtet.



Ai stan atë bylmet pat!



Nga: Muhamet MAVRAJ

Qeveria jonë nuk ka marrë urim nga Shtëpia e Bardhë kurrë! Vetëm kjo! Kemi ca kontakte periferike me Ministrinë e Jashtme amerikane, por gjithnjë më të ulëta!

Pavarësisht prej vardisjeve njëvjeçare dhe servilizimeve të ulëta së fundmi, urimi dhe mikpritja e Shtëpisë së Bardhë nuk po duken në horizontin perspektiv. Përkundrazi! Ambasadori amerikan iku ca muaj para kohe, ndërsa ne nuk kemi fare ambasador atje,

sikurse as në shumë qendra botërore të botëkuptimit të demokracive perëndimore. Së fundi, miku na konfirmoi se kemi rënë në grup me bllokun ruso-kinez. 37 shtete evropiane morën ftesë për Samitin e Demokracive, por jo edhe Kosova, Bjellorusia, Serbia, Bosnja, Hungaria e Turqia.

Ndoshta ka edhe më poshtë sesa ky nivel ku jemi, por në këtë klub me zihet fryma. Megjithatë, ende them: durojmë edhe pak. Jo

dorëheqje e shkarkime pa u ngi mirë!

Kombi ynë ka qenë, është dhe do të mbetet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sado që propaganda e klubit përpiqet ta bëjë fjalë të ndytë këtë emër. Deklaratat qeveritare për aleat më të mirë sesa ky, dihet se ku ushqehen dhe ku e kanë vendin.

Koha e Kosovës po abuzohet! Edhe pak! Veç le të dihet që e dinim gjithmonë dhe s'po befashem asnjëherë, aspak!

Mesiq: Kthimi i Serbisë në Kosovë është një iluzion

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kryetari i fundit i Kryesisë së ish-RFJ-së dhe ish-presidenti i Kroacisë, Stjepan Mesiq, duke folur për çështjen e mosnjohjes së Kosovës nga Serbia, ka thënë se politika serbe është "shumë agresive".

Mesiq, megjithatë, beson se Kosova është një çështje teknike dhe Serbia nuk mund ta marrë Kosovën në asnjë mënyrë. "Është një iluzion", ka deklaruar Mesiq, raporton "Al Jazeera".

Mesiq vlerëson se problemi i rajoni, i cili më vonë reflektohet në të tjerët, është se pas luftës, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, Serbia, e cila filloi luftën, nuk përjetoi katarsis pas luftës. "Dhe ata që erdhën në pushtet në Serbi nuk ishin kundër Millosheviqit sepse shkoi në luftë, por sepse ai nuk e fitoi luftën", tha Mesiq, një nga pjesëmarrësit në Forumin e Tetë në Baku. Sipas tij, në anën tjetër është Kroacia, e cila në masë të madhe ka

ruajtur marrëdhëniet që ekzistojnë në kohën e Tuxhmanit, i cili bashkë me Millosheviqin e ndau Bosnjën e Hercegovinën. "Tani keni ata trashëgimtarë që mendojnë se në botë ka ardhur koha që Bosnja e Hercegovina të ndahet përsëri", paralajmëroi ai.

Ai thotë se kishte përpjekje që Mali i Zi të kthehet në një marrëdhënie. "Ata provuan gjithçka dhe tani kanë që në aspektin fetar të prishin marrëdhëniet që janë krijuar në Mal të Zi. Më duket se kjo është e përkohshme, por e gjithë kjo lë shumë nervozizëm në rajon", vlerëson Mesiq.

Ai fajëson edhe Bashkimin Evropian, sepse nuk i ka zgjidhur disa nga problemet e brendshme. "Bashkimi Evropian sot nuk ka një lider që ka vizion. Ka zyrtarë që i mbajnë gjërat, por nuk ofrojnë rrugëdalje. Nuk kemi liderë që do të tërheqin vendet që nuk janë në




Bashkimin Evropian për t'iu bashkuar BE-së sa më shpejt të jetë e mundur. Nga njëra anë ka humbur entuziazmi i atyre që duan të anëtarësohen

në Bashkimin Evropian dhe nga ana tjetër ju jeni lodhur duke u anëtarësuar. Natyrisht, këta liderë nuk e dinë se fati i Evropës është në bashkimin e

saj. E gjithë kjo vonesë në zgjerimin e Bashkimit Evropian dëmton vetë BE-në dhe politikën botërore", tha Mesiq.

460 raste me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka njoftuar se të dielën, më 7 nëntor, janë regjistruar 19 raste me koronavirus, pas testimit të 2 174 mostrave.

Në 24 orët e fundit nuk është regjistruar asnjë viktimitë. Autoritetet shëndetësore kanë thënë se më 7 nëntor pesë persona janë shëruar derisa 460 persona janë ende aktivë në koronavirus.

Ndërkohë, Shtabi i Krizës i Komunës së Mitrovicës së

Veriut, i cili përfshin të dhënat nga të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë, ka njoftuar të shtunën, më 6 nëntor, se në dy ditët e fundit në këto komuna janë regjistruar dy viktima dhe 76 raste të reja.

Sistemi shëndetësor në komunat e banuara me shumicë serbe në Kosovë është krejtësisht i ndarë nga sistemi shëndetësor qendror i Prishtinës zyrtare.

Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë

Publike në Kosovë ka regjistruar mbi 160 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 978 persona kanë vdekur.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka bërë me dije të dhënat për vaksinim në periudhë 24-orëshe.

Deri më 6 nëntor 739 997 persona janë vaksinuar plotësisht kundër këtij virusi derisa 841 269 persona kanë marrë dozën e parë. Kjo i bie që deri në atë datë është vaksinuar plotësisht 41.1 për qind e popullsisë së përgjithshme.

PDK-ja dhe AAK-ja bëjnë koalicion në Vushtri

VUSHTRRI, 7 NËNTOR - Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kanë arritur

marrëveshje koalicioni në qytetin e Vushtrrisë për raundin e dytë të zgjedhjeve që do të mbahet më 14

nëntor. Kështu ka bërë me dije nëpërmjet një njoftimi zëdhënësi i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në

Vushtri, Lorik Maxhuni. Me anë të kësaj marrëveshje AAK-ja do ta mbështesë PDK-në më 14 nëntor.





FLET PËR "EPOKËN E RE", MARTINA SOMMER, UDHËHEQËSE E DEPARTAMENTIT PËR MIGRIM DHE INTEGRIM NË ORGANIZATËN AWO NË GJERMANI

Në Kosovë është arritur shumë, por ka shumë për t'u bërë

Udhëheqësja e Departamentit për Migrim dhe Integrim në Organizatën AWO në Gjermani, Martina Sommer, është shprehur e kënaqur me realizimin e projekteve të shumta në Kosovë që kanë pasur për qëllim përkrahjen e njerëzve të kthyer vullnetarisht nga Gjermania. Ajo ka treguar se për aktivitetet e kësaj organizate qytetarët e Kosovës tregojnë shumë besim. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Sommer ka deklaruar se nga viti 2007 në Kosovë kanë ndodhur shumë gjëra pozitive. Ajo ka bërë me dije se Kosova është një vend i ri me njerëz të cilët kanë pritshmëri për të ardhmen. Në këtë intervistë Sommer ka folur edhe për projekte e reja të qendrës këshilluese të "AWO Nürnberg" në Kosovë

PRISHTINË, 7 NËNTOR -

"Epoka e re": Znj. Sommer, çfarë organizate është "AWO Nürnberg" dhe me çka merret?

Sommer: AWO është një nga organizatat më të mëdha të mirëqenies vullnetare në Gjermani. Është aktive mbi 100 vjet në punën sociale. AWO ofron një spektër të gjerë të ofertave. Ka çerdhe të fëmijëve, shtëpi të përkujdesjes së të moshuarve, këshillim për persona që gjenden në vështirësi, ndihmë për të pastrehë dhe përkrahje për

migrantë dhe shumë më shumë. Një pikë kyçe e AWO Nürnberg është këshillimi dhe përcjellja e migrantëve dhe refugjatëve.

"Epoka e re": Cilat kanë qenë arsyet që kjo organizatë ka zgjedhur që aktivitetin e saj ta shtrijë në Kosovë?

Sommer: AWO Nürnberg këshillon që nga viti 2003 migrantët që dëshirojnë të kthehen në vendlindjet e tyre. Me qëllim të përkrahjes së këtyre njerëzve, në Bayern

është ndërtuar një rrjet i qendrave të këshillimit për të kthyer. Këtu përfshihet edhe përkujdesja në vendin e lindjes pas largimit nga Gjermania. Në qendrën tonë të këshillimit në Nürnberg, kemi pasur shumë prej tyre që kanë dashur të kthehen në Kosovë. Kështu ka qenë edhe e kuptueshme, që ne si AWO të angazhohemi edhe në këtë vend të kthimit. Me Kosovën kemi gjetur një fqinj evropian me të cilin bashkëpunojmë me dëshirë dhe sukses.

"Epoka e re": Që sa kohë veproni në Kosovë?

Sommer: AWO Nürnberg është aktiv në Kosovë që nga viti 2007. Në fillim përmes një projekti bashkëpunimi me Ministrinë për Migrim dhe Refugjatë. Që nga viti 2009 kemi zyrën tonë në Prishtinë dhe që nga viti 2015 edhe në Prizren. Që nga janari 2021 kemi filluar me një projekt të ri i cili quhet "Hallo Deutschland" dhe u dedikohet punëtorëve të kualifikuar të cilët kanë vendosur të punojnë në Gjermani. Ne i përkrahim punëtorët e kualifikuar dhe familjet e tyre për përgatitjen për jetën në Gjermani.

"Epoka e re": Po nga kush financohen këto projekte?

Sommer: Projekti i riintegritimit financohet nga Zyra e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Zyra Shtetërore Bavareze për Azil dhe Kthim. Projekti "Hallo Deutschland" është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian nga Fondi për Azil, Migrim dhe Integrim.

"Epoka e re": Si është pritur kjo organizatë nga qytetarët e Kosovës?

Sommer: Ndaj nesh është treguar dhe tregohet shumë besim. Ndihamat praktike të cilat ne ofrojmë si, p. sh., pako ushqimore, ndihmë për rinovim apo ilaçe vlerësohen shumë nga ndihmëkërkuessit, por edhe këshillimi social dhe psikologjik pranohet me shumë dëshirë. Në veçanti të pëlqyera janë aktivitetet tona grupore me fëmijë dhe të rinj. Në këto grupe mësohet, luhet dhe qeshet së bashku. Aktivitetet e kohës së lirë si noti, skijimi, ekskursionet janë një ndryshim i mirëpritur në jetën e përditshme të shqetësuar shpesh të familjeve. Po ashtu, edhe bashkëpunimi

me autoritetet e Kosovës dhe organizatat e ndryshme është një partneritet i besueshëm. Për çështje të klientëve përkrahim njëri-tjetrin dhe kërkojmë zgjidhje së bashku.

"Epoka e re": Cila është përshtypja juaj për Kosovën? Sa ka ndryshuar ky vend prej kur keni ardhur ju?

Sommer: Në vitet e shumta të angazhimit tim për Kosovën kam takuar shumë njerëz miqësorë, pozitivë që janë përplot guxim dhe shpresë. Vendi është i ri dhe përplot pritshmëri për një të ardhme më të mirë. Që nga viti 2007 kanë ndryshuar shumë gjëra pozitivisht: Infrastruktura është ndërtuar masivisht, qytetet janë zbuluar dhe janë bërë më të përshtatshme për jetesë. Prapëseprapë për shumë njerëz zhvillimi nuk ecën mjaftueshëm shpejt. Kjo gjë është e kuptueshme pasi që vendi, në krahasim me Evropën, ka shumë për të arritur: ekonomikisht, por edhe në çështjet shëndetësore dhe sociale. Kosovën e kam në zemër dhe kur nuk vij këtu një kohë të gjatë me kaplon malli për këtë vend.

Kosova, i vetmi shtet në rajon pa vaksinë kundër HPV



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Në Kosovë vaksina kundër papilloma virusit (HPV), e cila mbron nga sëmundja e kancerit të qafës së mitrës, nuk është në kalendarin e vaksinimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Papilloma virus është infeksioni më i zakonshëm i cili transmetohet përmes marrëdhënieve seksuale. Ky infeksion mund të shkaktojë disa probleme shëndetësore duke përfshirë edhe sëmundjen e kancerit të qafës së mitrës.

Vaksina HPV, në bazë të studimeve të bëra së fundmi nga Organizata e Britanisë së Madhe "Cancer Research", tregon se kjo vaksinë ka zvogëluar rastet e kancerit të qafës së mitrës për gati 90 për qind.

Kanceri i qafës së mitrës vret qindra mijëra gra çdo vit në botë dhe është kanceri i dytë më i zakonshëm te gratë, thonë profesionistët shëndetësorë. Nëse zbulohet me kohë, profesionistët shëndetësorë thonë se është 100 për qind i shërueshëm.

Shpresa është se përmes vaksinimit sëmundja mund të eliminohet.

Sipas të dhënave të Klinikës së

Onkologjisë në Kosovë, në vit trajtohen deri në 120 gra me sëmundjen e kancerit të qafës së mitrës.

Numri i rasteve që përfundojnë me vdekje nuk dihet.

Profesionistët shëndetësorë të fushës së onkologjisë, me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë, u bëjnë thirrje institucioneve të shëndetësisë që ta fusin vaksinën kundër Papilloma virusit (HPV) në kalendarin e vaksinimit. Drejtori i kësaj Klinike, Ilir Kurtishi, thotë për Radion Evropa e Lirë se në të kaluarën kanë diskutuar me autoritetet për rëndësinë e kësaj vaksine, por deri më tani nuk ka diçka që ka filluar në këtë aspekt. "Mendimi ynë është se kjo vaksinë duhet të fillojë të jepet edhe në Kosovë siç bëhet në të gjitha vendet e Evropës pasi që kjo e zvogëlon numrin e rasteve të qafës së mitrës. Por, kjo është një çështje që merret nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik dhe ekspertët që merren me trajtimin të sëmundjes", thotë Kurtishi.

Ministria e Shëndetësisë nuk është përgjigjur në pyetjet e Radios Evropa e Lirë se a do të shqyrtojë përdorimin e kësaj

vaksine. Por, bisedat lidhur me këtë vaksinë në Kosovë datojnë nga viti 2018. Në atë vit zyrtarë të MSh-së patën deklaruar për Radion Evropa e Lirë se kjo vaksinë bart kosto të lartë financiare.

Vaksina HPV shpëton jetë

Nisur nga të gjitha studimet e bëra që vaksinën HPV e shohin si mundësi të mirë për zvogëlimin e kësaj sëmundjeje, kryetari i Shoqatës së Onkologëve, Arben Bislimi, thotë se në një situatë të tillë nuk ka shumë alternativa. Ai thotë për Radion Evropa e Lirë se institucionet vendimmarrëse duhet ta fusin këtë vaksinë në kalendarin e imunizimit. "Jo vetëm ky studim, por edhe studimet e mëhershme tregojnë se kanceri i qafës së mitrës, diku 95 për qind të shfaqjes është si pasojë e infeksionit me human Papiloma virus. Derisa e dimë shakatarin që vjen deri te sëmundja, atëherë në këtë situatë parandalimi është vaksinimi", thotë Bislimi.

Kosova, shton Bislimi, duhet të fillojë me kalendar të rregullt të vaksinimit për HPV për moshat 9-12 vjeç dhe prej 13- 25 për ato

gra që nuk janë vaksinuar më herët.

Studimi i Organizatës së Britanisë së Madhe "Cancer Research" ka vë në pah se shkurtimi i rrezikut ishte më i dukshëm tek ata që ishin vaksinuar në moshat më të hershme të mundshme 12-13 vjeç, me një rënie prej 87-përqindësh. Ata të imunizuar nga moshë 16-18 vjeç kishin një rënie të rrezikut prej 34-përqindësh.

Në disa shtete të rajonit vaksina HPV është e obligueshme

Vendet e rajonit si Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Mali i Zi në kalendarin e vaksinimit kanë vaksinën kundër Papilloma virusit. Në Maqedoninë e Veriut kjo vaksinë është në kalendar, ndërsa që nga viti 2013 është obligative për gratë e moshës 12 deri në 26 vjeç dhe jepet në tri doza.

Në kalendarin e vaksinimit të këtij shteti ceket se kjo vaksinë duhet të jepet për vajzat në klasën e gjashtë. Edhe Serbia vaksinën HPV e ka në kalendar të vaksinimit. Vaksina nuk është e obligueshme, por e

rekomanduar. Sipas të dhënave, në Serbi deri në 1 500 gra çdo vit sëmurën nga kanceri i qafës së mitrës dhe kacereve të tjera, kurse vdesin 600 prej tyre.

Derisa vaksina është e rekomanduar dhe jo e detyrueshme sigurimi shëndetësor në Serbi nuk mbulon kostot e vaksinimit. Çmimi i vaksinës është rreth 300 euro.

Mali i Zi në vitin e kaluar kishte ndarë buxhet për vaksinën HPV, por ato mjete u përdorën për nevojat e trajtimit të pandemisë Covid-19.

Sipas autoriteteve në Mal të Zi, vaksinimi me vaksinën kundër kancerit të qafës së mitrës do të vazhdojë kur të ketë një situatë më të favorshme epidemiologjike me Covid-19. Në këtë shtet, sipas të dhënave, rreth 110 gra në vit trajtohen me sëmundjen e kancerit të qafës së mitrës.

Vaksina HPV është në përdorim edhe në Bosnje. Vaksina nuk është e obligueshme dhe ajo mund të blihet në barnatore me një çmim prej 180 eurosh. Në këtë shtet brenda një viti 550 gra trajtohen nga kanceri i qafës së mitrës, kurse 140 vdesin.

Bëhet thirrje të ndryshohet dizajni i fletëvotimeve

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Isak Krasniqi, teknik i pensionuar i makinerisë, nuk është i sigurt nëse vota e tij ka qenë e vlefshme në zgjedhjet lokale të mbajtura më 17 tetor në Kosovë. Ai thotë se mosinformimi i duhur për procesin zgjedhor është arsyeja që, sipas tij, edhe mund të ketë gabuar. “Në zgjedhjet e fundit lokale, fletëvotimet më janë dukur shumë të komplikuar. Një fletëvotim e paraqet partinë, fletëvotimi tjetër nuk kishte asgjë të përbashkët me të. Nuk jam aspak i sigurt se kam votuar mirë. Por, unë gjithmonë dal në zgjedhje, votoj si di”, thotë ai. “Mënyra e votimit duhet të shfaqet shpesh nëpër televizione në mënyrë që populli të kuptojë sesi duhet të votohet”, shton Krasniqi.

Mbi 90 mijë është numri i fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta në zgjedhjet e fundit lokale në Kosovë.

Nga këto shifra, sipas të dhënave të pacertifikuara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mbi 13 mijë janë për zgjedhjet për

kryetarë të komunave dhe mbi 56 mijë për kuvendet komunale. Këtij numri i shtohen edhe 13 mijë fletëvotime të tjera ku votuesit i kanë lënë të zbrazëta, duke mos votuar për askënd.

Numri i votuesve në këto zgjedhje ka qenë mbi 811 mijë. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës, organizatë kjo që ka monitoruar procesin zgjedhor, thotë se kjo situatë është e papranueshme dhe duhet të adresohet menjëherë, duke punuar në ndryshimin e dizajnit të fletëvotimeve dhe ndryshimin e kampanjave për informim të votuesve lidhur me mënyrën e votimit. “Në një situatë të tillë ndikim të madh ka edhe dizajni i fletëvotimit, mirëpo edhe vetë mënyra e votimit, sepse qytetarët marrin dy fletëvotime, pastaj mund të krijohen huti të tilla. Për këtë arsye ne kemi rekomanduar që të bëhet një rishikim i dizajnit të fletëvotimeve dhe kampanjave për informim”, shprehet Cakolli, raporton “Radio Evropa e Lirë”.

Duke llogaritur numrin e këtyre fletëvotimeve, Cakolli shprehet se votat e pavlefshme dhe të zbrazëta është “subjekti” i pestë në zgjedhjet lokale. “Në fakt, përveçse është një prej ‘subjekteve’ më të votuara, ne kemi pasur situatë të njëjtë edhe në zgjedhjet parlamentare kur votat e pavlefshme teknikisht e kanë kaluar pragun zgjedhor. Madje në disa raste në zgjedhjet komunale, në disa komuna përqindja e fletëvotimeve arrin në 20 për qind, që është subjekti i dytë më i votuar brenda asaj komune”, ka theksuar ai.

Valmir Elezi, zëdhënës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), thotë se sa i përket informimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vazhdimisht punon drejt informimit dhe edukimit të votuesve përmes fushatave informuese apo aktiviteteve direkte me qytetarë.

Ai tregon se në zgjedhjet e fundit numri i fletëvotimeve ka qenë më i vogël se në zgjedhjet e kaluara të mbajtura në vitin

2017. “Në vitin 2017, pa llogaritur fletëvotimet e zbrazëta, numri i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave ka qenë 13 814 fletëvotime apo 1.65 për qind. Ndërsa në zgjedhjet për kuvende komunale ky numër ka qenë 65 370 apo 7.88 për qind”, tha ai. Sipas Elezit, në zgjedhjet e vitit 2021 numri i fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave ka qenë 13 097 fletëvotime apo 1.61 për qind, ndërsa në zgjedhjet për kuvende komunale ky numër ka qenë 56 179 apo 6.91 për qind”, tha ai.

Zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021 ishin të katërtat që u zhvilluan pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Elezi thotë se komisioni bën analizimin e fletëvotimeve të pavlefshme për t’i evidentuar arsyet dhe natyrën e pavlefshmërisë së këtyre fletëvotimeve. “Nga proceset e kaluara zgjedhore, gjatë analizimit të fletëvotimeve të pavlefshme të zgjedhjeve për kryetar apo për kuvende, kemi

vërejtur raste kur është votuar më shumë se një kandidat apo më shumë se një subjekt politik; dëmtim të qëllimshëm të fletëvotimeve si dhe fletëvotime të paplotësuar”, tha ai. Në bazë të rezultateve përfundimtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lidhja Demokratike e Kosovës ka dalë e para me vota për kuvendet komunale, përkatësisht 170 mijë të tilla, pasuar nga Lëvizja Vetëvendosje me 168 mijë vota, e treta renditet Partia Demokratike e Kosovës me 161 mijë vota, e katërta për nga numri i votave paraqitet Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 90 mijë dhe Lista Serbe me mbi 50 mijë vota.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) më 3 nëntor ka bërë shpalljen e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet lokale të 17 tetorit në Kosovë. Sipas këtyre rezultateve, 21 komuna do të garojnë në raundin e dytë në balotazh, ndërsa në 17 komuna është vendosur fituesi në raundin e parë.



Sot zyrtarisht nis fushata për balotazhin

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Sot (e hënë) edhe zyrtarisht nis fushata zgjedhore për balotazhin. Kjo fushatë zgjedhore do të zgjasë pesë ditë siç është përcaktuar nga Komisioni Qendror Zgjedhjeve. “KQZ-ja ka vendosur për kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Janë 5 ditë në

dispozicion të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për t’i zhvilluar aktivitetet në kuadër të fushatës zgjedhore, duke filluar nga 8 nëntori deri më 12 nëntor”, ka thënë për Klankosova.tv zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Valmir Elezi. Partitë politike thuajse për asnjë ditë nuk i kanë ndaluar aktivitetet e fushatës edhe pas

përfundimit të raundit të parë dhe përcaktimit të afatit nga KQZ.

Votimet për raundin e dytë të zgjedhjeve do të mbahen të dielën më 14 nëntor.

Raundi i dytë i zgjedhjeve do të mbahet në 21 komuna, ku asnjëri nga kandidatët për kryetarë të komunave nuk arriti të marrë 50+1 për qind të votave.



BERZh-i: Kosova, e treta në rajon me rritjen ekonomike për vitin 2021

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) vlerëson se rritja ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2021 do të jetë 7.7 për qind. Shqipëria renditet e dyta në rajon. Renditjen e kryeson Mali i Zi me 12.3 për qind dhe listën e mbyll në vend të fundit Maqedonia e Veriut me 4 për qind. Pas Bankës Botërore (BB) dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), është BERZh-i që raporton për rritje me ritme më të shpejta të ekonomisë në vend sesa parashikimet e fillimvitit. Në raportin e saj të fundit "Perspektiva Ekonomike Rajonale (REP)", BERZh-i rriti dukshëm projeksionet për rritjen ekonomike të Kosovës në vitin 2021 nga minus 5.3 për qind që ishte në vitin e kaluar. "Ekonomia e Kosovës po rimëkëmbet kryesisht falë një sektori të jashtëm mbështetës. Eksportet e shërbimeve - më shumë se katërfishi i eksporteve të mallrave para pandemisë, u dyfishuan në shtatë muajt e parë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, kryesisht për shkak të flukseve hyrëse të lidhura me udhëtimet. Eksportet e mallrave gjithashtu u rritën

bindshëm", ka njoftuar BERZh, raporton "Telegrafi". Po ashtu, sipas BERZh-it, rritja e remitencave dhe zgjerimi i marrjes së kredive është një nga faktorët e rritjes ekonomike të Kosovës. "Konsumi i familjeve po mbështetet nga një fluks në rritje i remitencave dhe nga zgjerimi i kredisë. Ekonomia e Kosovës parashikohet të rritet me 7.7 për qind në 2021 dhe 4.5 në vitin 2022", thuhet në raport. Banka Botërore në raportin "Konkurrenca dhe rimëkëmbja pas pandemisë Covid-19", shprehet se rritja e konsumit me ardhjen e mërgatës ka kontribuar në rritjen ekonomike të Kosovës për vitin 2021. Sipas BB-së, deri në fund të këtij viti kjo rritje do të jetë 7.1 për qind, kundrejt një tkurrje prej 5.3-përqindësh që ishte vitin e kaluar. "Aktiviteti ekonomik në vitin 2021 pritet të zgjerohet me 7.1 për qind kundrejt një rikthimi të mërgatës, masave mbështetëse fiskale dhe rritja e huadhënies. Modeli i rritjes së Kosovës është kryesisht i bazuar në konsum, me një mbështetje të konsiderueshme nga mërgata", thuhet raport. Ndërsa BQK thotë se ekonomia e



Kosovës pritet të rritet në 9.9 për qind gjatë vitit 2021. "Sipas vlerësimeve, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2020 ka shënuar rënie prej 5.3-përqindësh. Efekti i rënies së ekonomisë është manifestuar përmes sektorit të jashtëm. Ndalimi i udhëtimit ka bërë që të bie në mënyrë drastike numri i mërgimtarëve dhe rënia e eksportit të shërbimeve të udhëtimit që në vitin 2020 zbriti në mbi 628 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 1.3-

miliard eurosh që ishte një vjet më parë", kishte thënë guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, gjatë raportimit në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere. Mehmeti është shprehur se në pjesën e parë të vitit 2021 ka pasur shtim të aktivitetit ekonomik prej 10.5-përqindësh. "Projeksionet e BQK-së tregojnë se aktiviteti ekonomik do të rikuperohet me një ritëm mjaft të shpejtë të rritjes prej 9.9-përqindësh për vitin 2021. Vetëm

në gjysmën e parë të vitit 2021 është shënuar një aktivitet i shtuar ekonomik prej 10.5-përqindësh", ka vijuar ai. Në fund, BERZh-i për vendet e Ballkanit Perëndimor parashikon një rritje prej 6.4-përqindësh për vitin 2021. BERZh-i bëri parashikimet e rritjes së këtij viti, por paralajmëroi se rritja e kostove të energjisë dhe përparimi i ngadaltë i vaksinimit kundër Covid-19 zbeh perspektivat e ardhshme ekonomike.

Rriten për 8.8 për qind çmimet e prodhimeve bujqësore në Kosovë

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore ka shënuar rritje për 8.86 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, thuhet në raportin e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Sipas ASK-së, në tremujorin e tretë të vitit 2021 Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Blegtorale ka rënie për 2.75 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, kurse Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bimore ka rritje për 16.99 për qind. Javët e fundit është vërejtur një rritje e theksuar e çmimeve për produktet bazë për konsum. Ngritjen e këtyre çmimeve e ka konfirmuar edhe ASK, duke



shtuar se Indeksi i tërësishëm i Harmonizuar i Çmimeve të

Konsumit është rritur kryesisht te produktet e mishit,

qumështit, perimet, uji e lëngjet, lëndët djegëse dhe

shërbimet hoteliere. Agjencia thotë se norma vjetore e inflacionit në muajin shtator ka arritur në 4.9 për qind. Nga të dhënat e Trading Economics del se Kosova është vendi i dytë me normën më të lartë të rritjes së çmimeve në rajon. E përveç këtyre rritjeve në produkte ushqimore në Kosovë, është paralajmëruar edhe rritja e çmimit të faturave të energjisë elektrike. E për këtë gjë qytetarët që ngrohen me rrymë thonë që do ta kenë shumë të vështirë pasi që do t'u duhet ta ndërrojnë komplet sistemin e ngrohjes, nga ajo me rrymë ta bëjnë me lëndë të tjera djegëse, sepse nuk mund t'i përballojnë kostot.

Inflacioni në ShBA arrin në nivelin më të lartë në tri dekada

NJU-JORK, 7 NËNTOR - Inflacioni në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka arritur nivelin më të lartë në tri dekada pasi një rritje e çmimeve të gazit dhe mallrave është pothuajse dyfishuar që nga viti i kaluar, duke detyruar drejtuesit e kompanive t'i rritin shpenzimet e tyre çdo muaj që prekin industri të shumta, përfshirë shitjen e makinave dhe bujqësinë.

Njerëzit zakonisht blejnë ushqime të freskëta në tregjet lokale të fermerëve, që shpesh është alternativa më e lirë. Megjithatë, rritja e kostove lidhur me transportin dhe zinxhirin e furnizimit ka ndikuar në çmimet e ushqimeve pasi fermerët kanë paguar më shumë për kostot. Ndërkohë, prodhimi dhe shpërndarja e automjeteve të

reja kanë pësuar një pengesë të madhe që nga fillimi i pandemisë pasi mjaft qytetarë kanë arritur fitime duke shitur automjete të përdorura që normalisht do të kishin rënë në vlerë vitet e fundit. Ekonomistët kanë shprehur shqetësime nëse kjo rritje e fundit e inflacionit mund të zgjidhet vetëm duke trajtuar krizën e zinxhirit të furnizimit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani barazon me Prishtinën, merr pozitën e dytë

Ballkani vazhdon të jetë skuadra lidere në Superligën e futbollit pasi mposhti Dritën. Në derbin tjetër të kësaj xhiroje, Gjilani ndau pikët me Prishtinën, po një pikë i mjaftoi që të ngrehet në pozitën e dytë. Të dielën tri pikë ka shijuar edhe Dukagjini në përballje me Feronikelin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Në derbin e zhvilluar të dielën në qytetin e Gjilanit, Gjilani dhe Prishtina kanë ndarë pikët duke barazuar 1-1 në ndeshjen e vlefshme për xhiron e 13-të në BKT Superligën e Kosovës në futboll. "Dy pikë të humbura ishim në avantazh, kishim një futbollist më tepër. Nuk arsyetohet ky rezultat. Ky barazim është i barabartë me humbje, duke i pasur parasysh rrethanat. Kishim epërsi numerike dhe u ndëshkuam. Nuk arritëm të shfrytëzojmë aspak epërsinë numerike. Ndoshta nuk e kam motivuar ekipin sa duhet. Kartoni i kuq (i Gjilanit) na bëri më shumë dëm se mirë. Duhet të luajmë me përgjegjësi. Nuk jemi aty ku duhet të jemi", ka thënë trajneri i Prishtinës, Zekrija Ramadani.

Ishte anësori Mendurim Hoti ai që e kaloi skuadrën kryeqytetase në epërsi në minutën e 31-të të ndeshjes. Me rezultat 0-1 përfundoi pjesa e parë. Useini i vendasve u ndëshkua me karton të kuq në minutën e 57 të ndeshjes. Gjilani arriti ta barazonte rezultatin në minutën e 67-të kur Gerhard Progni shënoi nga penalltia. "Jam shumë i kënaqur me lojën, me angazhimin e futbollistëve. Kemi luajtur me të vërtetë mirë. Më dhimbset situata te goli. Nuk e di a ishte faull te lojtari ynë apo jo, por këto interpretime po bëhen kush si po dëshiron. Kemi luajtur më të motivuar me një futbollist më pak dhe duhet dhënë më shumë për të nxjerrë rezultat pozitiv. Në të gjitha ndeshjet derbi po mbesim me një lojtar më pak. Është pak e tepërt, mendoj, se ajo ndërhyrje nuk ka qenë për karton të kuq. Është kartoni i tretë i kuq që kemi marrë nga gjyqtari Dardan Çaka. Ai duhet ta ndiejë më shumë lojën",



ka thënë pas ndeshjes trajneri i Gjilanit, Ismet Munishi. Pas këtij barazimi, Gjilani ngrehet në pozitën e dytë në tabelë me 22 pikë, dy më pak se lideri, Ballkani. Në anën tjetër, Prishtina mbetet e gjashta me 17 pikë të tubuara. Të dielën Dukagjini ka shënuar kundër Feronikelit me rezultat minimal 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Bujar Shabani në minutën e 76. Dukagjini ngjitet në vendin e tetë me 14 pikë të tubuara, kurse Feronikeli mbetet në vendin e fundit me 10 pikë. Skuadra e Ballkanit është rikthyer në pozitën e parë në renditjen e BKT Superligës, pasi ka shënuar fitore ndaj skuadrës së Dritës, e cila qëndroi për një javë lidere. Portokallezinjtë nga Suhareka fituan në shtëpi, me rezultat 2-0, në kuadër të javës së 13-të. Të dyja golat për skuadrën e drejtuar nga Bekim Isufi i realizoi Theophilus Solomon. Ai i zhbllokoi shifrat në minutën e 54-t, derisa katër minuta më vonë realizoi edhe golin e dytë, i cili fillimisht u vlerësua i parregullt nga gjyqtari anësor për pozitë jashtëloje por, pas rishikimit në VAR, goli doli të jetë i rregullt. Kësisoj, Ballkani tashmë kryeson renditjen me 24 pikë, derisa Drita renditet e dyta

me 22 pikë. Ndërkohë, në dy ndeshjet e tjera të ditës së sotme fitoreve iu gëzuan mysafirët. Llapi arkëtoi tri pikë të reja në duel me Malishevën (1-0) falë autogolit të Ardian Hotit në minutën e 84-t, kurse Ulpiana realizoi fitoren e tretë radhazi, duke e mundur Drenicën në Skenderaj (1-0), me golin e shënuar nga Marclei Santos në minutën e 85-të.

BKT Superliga

Gjilani - Prishtina	1-1
Dukagjini - Feronikeli	1-0
Ballkani - Drita	2-0
Drenica - Ulpiana	0-1
Malisheva - Llapi	0-1

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	24
2. Gjilani	22
3. Drita	22
4. Drenica	20
5. Llapi	18
6. Prishtina	17
7. Ulpiana	16
8. Dukagjini	14
9. Malisheva	12
10. Feronikeli	10

SHKURT

Kryeziu shënon gol të jashtëzakonshëm nga gjuajtja e lirë

Mirlind Kryeziu ka realizuar një gol të jashtëzakonshëm në javën e 13-të në Superligën e Zvicrës. Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës e ka nisur si gjithnjë nga minuta e parë ndeshjen për Zurichun përballë Servettes. 24-vjeçari ka arritur ta shënojë golin e dytë për skuadrën e tij në minutën e 44-t. Ishte një gjuajtje e lirë për skuadrën mysafire, derisa Kryeziu shënoi gol të mrekullueshëm nga një distancë prej 30 metrave. Në mediat zvicerane po konsiderohet si ndër golat më të bukur këtë edicion në Superligën e Zvicrës.

Rashica, pas shkarkimit të trajnerit: Faleminderit për gjithçka, shefi!

Shkarkimi i trajnerit Daniel Farke nga Norwich City e ka lënduar sulmuesin e Kosovës dhe klubit anglez, Milot Rashicën. Norwich City dje (e shtunë) mori fitoren e parë këtë sezon në Ligën Premierë, pasi mposhti Brentfordin me rezultat 2-1. Megjithatë, kjo fitore nuk kreu punën për trajnerin Farke, i cili pas ndeshjes u shkarkua nga drejtuesit. Klubi anglez njoftoi shkarkimin e trajnerit pas 208 ndeshjeve dhe katër vjet e gjysmë në krye të skuadrës. Ky shkarkim i Farkes ka lënduar sulmuesin e Kosovës, Rashicën, i cili nuk ka mundur të mos reagojë në rrjetet sociale. "Faleminderit për gjithçka, shefi!", ka shkruar Rashica në postimin e bërë në "Instagram". Ndryshe, Farke njihet si personi kryesor që ndikoi në transferimin e Rashicës te klubi anglez në afatin kalimtar të verës së fundit.

Gjyqtarët e Kosovës dhe Kurshumlja në ndeshjet ndërkombëtare

FIBA Instruktori Nacional i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Komisari i Garave të FBK-së, Faton Kurshumlja, ka qenë vëzhgues në ndeshjen e FIBA EuroCup Women 2022 në Turqi mes Elazig Ozel Idare dhe Uni Gyor, si dhe në dy takimet e tjera Orman Genclik-DVTK e Mersin-Horizont. Këto ishin takime të vlefshme në grupet e edicionit të rregullt. Ndërkohë, Kurshumlja ka qenë vëzhgues në sfidën Shqipëri - Luksemburg në parakualifikimet e Eurobasketit 2025 në Durrës te meshkujt. Gjyqtari Xhelal Mumini ka ndarë drejtësinë në FIBA EuroCup Women 2022 në Turqi gjatë muajit tetor në ndeshjet Elazig Ozel Idare-Uni Gyor dhe Orman Genclik-Ludovika-FCSM Csata.

Dardan Maxhuni ka ndarë drejtësinë në sfidën Mersin - Horizont që është zhvilluar në Turqi gjatë muajit tetor në fazën e grupeve. Ndërkohë, Daut Mehmeti ka qenë gjyqtar në ndeshjet Hatayspor Kulubu Dernegi - Enisey Krasnoyarsk, Bellona Kayseri - Universitas PECS dhe Elazig IL Ozeldare - BC Prometey, të gjitha të zhvilluara në kuadër të FIBA Euro Cup Women.

Shtatë boksierë në turneun 'Gongu i Artë'

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kosova do të paraqitet me shtatë boksierë në turneun ndërkombëtar "Gongu i Artë" që organizohet në Shkup nga 10 deri më 14 nëntor. Garuesit që do ta përfaqësojnë vendin tonë në këtë turne janë: Bashkimi Bajoku (54 kg),

Shpetim Bajoku (63.5 kg), Patriot Behrami (71 kg), Jozef Rrasi (71 kg), Imer Mangjoll (75 kg), Altin Shala (80 kg), Remzo Mustafiç (86 kg), të cilët do të udhëhiqen nga trajnerët Besim Brahimi dhe Lirim Shllaku. Edhe dy gjyqtarë nga Kosova do të jenë

pjesë e këtij turneu. Latif Demolli dhe Marigona Beadini janë në mesin e gjyqtarëve të përzgjedhur për ndarjen e drejtësisë. Në turneun "Gongu i Artë" që shënon edicionin e 50 jubliar. Në të kaluarën boksierët tanë kanë arritur të fitojnë medalje

të shumta. Kjo garë shihet si një sprovë e mirë për boksierët e Kosovës në prag të turneut ndërkombëtar "Adem Jashari" që mbahet më 20-21 nëntor në Prishtinë dhe që do të jetë gara e fundit e



rëndësishme në kalendarin e Federatës së Boksit.

Bagnaia fiton në Portugali

Lisbonë, 7 nëntor - Piloti italian i Ducatit, Francesco Bagnaia, fitoi sot garën e Çmimit të Madh të Portugalisë në MotoGP, zhvilluar në pistën e Algarve. Suksesi i tretë sezonal për Bagnaia, një fitore më së shumti për statistikë,

pasi titulli kampion për pilotë, është mbyllur dy javë më parë, fituar nga francezi Fabio Quartararo (nuk e mbylli garën). Gjithsesi, gara e sotme nuk u mbyll, pasi dy xhiro nga fundi u valëvit flamuri i kuq, pas aksidentit mes spanjollit

Iker Lacuna dhe portugezit Miguel Oliveira. Ky i fundit pati një dëmtim më të rëndë se kolegu i tij, duke detyruar organizatorët e garës ta mbyllnin atë para kohe. Gjithsesi, të dy pilotët janë jashtë rrezikut për jetën. Për sa

i përket garës, ajo u dominua nga Bagnaia, që e nisi atë nga vendi i parë, pas "pole" që siguroi dje. I dyti u klasifikua spanjoll i Suzuki, Joan Mir, që la pas australianin Jack Miller me motorin tjetër Ducati. Motori italian dominon



renditjen e MotoGP për konstruktorë pas kësaj gare, duke lënë pas Yamaha.

Fitore e rëndësishme për Prizrenin 16, Vllaznia triumfon ndaj Tiranës

PRIZREN, 7 NËNTOR - Prizreni 16 ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 95:89 (22:23, 36:21, 20:25, 17:20) në xhiron e tretë të Ligës Unike. "Vreshtarët" e nisën ndeshjen me një seri prej 0:6, megjithatë vendasit rikthehen shpejt dhe më pas zhvillohet lojë e baraspeshuar, ndërsa çereku i parë përfundon me rezultat 22:23. Prizrenasit e filluan furishëm periudhën e dytë, duke pasur epërsi deri në 12 pikë, 40:28 dhe ishin në epërsi konstante, kurse pjesa e parë përfundoi me shifrat 58:44. Lojë interesante u zhvillua në periodën e tretë, ku mysafirët ngushtuan shifrat në 67:62, megjithatë vendasit me një seri prej 10:0 u shkëputen në 77:62, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 78:69. Rahoveci nuk u dorëzua dhe ngushtoi rezultatin në 88:85, por pa arritur të bëjë më shumë dhe Prizreni 16 triumfoi me shifrat 95:89. Te Prizreni 16 u dalluan Urim Zenelaj me 13 pikë e 17 kërcime, Ivan Koljeviq me 27 pikë e nëntë asistime dhe Courtney Fells me 24 pikë e 11 kërcime, kurse te Rahoveci u dalluan Milik Yarbrough me 23 pikë e 15 kërcime, Altin Morina me 24 pikë e gjashtë asistime dhe Tyheim



Monroe me 20 pikë e 10 kërcime. Prizrenasit kanë dy fitore dhe një humbje, ndërsa Vreshtarët tri fitore në tri ndeshje. Ndërsa Vllaznia ka shënuar fitore ndaj Tirana Neptunit me rezultat 87:68 (30:19, 20:17, 20:21, 17:11), në kuadër të xhiros së tretë të Ligës Unike. Vendasit e nisën ndeshjen shumë më mirë, duke qenë në epërsi konstante në çerekun e parë, ku më e larta ishte 30:19, sa përfundoi kjo pjesë, duke u dhënë komoditet shkodranëve për vazhdim të ndeshjes. Vendasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke e ngritur epërsinë edhe më shumë, në 36:19, e më pas edhe 46:27, ndërsa

pjesa e parë përfundoi me rezultat 50:36. Kryeqytetasit nuk u dorëzuan dhe ngushtuan shifrat maksimalisht në 52:51, megjithatë shkodranët sërish u shkëputën në 70:57, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Vllaznia menaxhoi lojën dhe epërsinë në 10 minutat e fundit për të mos e rrezikuar fitoren, kurse triumfoi në fund me rezultat 87:68. Te Vllaznia më i miri në parket ishte J Stove me 26 pikë e tetë kërcime, kurse te Tirana Neptuni u dalluan Julian Hamati me 18 pikë e tetë kërcime dhe Endrit Hysenagolli me 21 pikë. Tashmë të dyja skuadrat kanë nga një fitore dhe dy humbje.

Lakersat turpërohen edhe nga Portlandi, Miami ndal hovin e Utah Jazzit

MIAMI, 7 NËNTOR - Vijon të zhgënjëjë në kampionat ekipi i lakersave, që u mund sot 105-90 nga Portlandi, humbja e pestë në kampionat, duke zbritur në vendin e 10 në Perëndim. Mungesa e James u ndje, ndërkohë që Davis luajti vetëm 7 minuta për shkak të një problem në stomak. Lillard me 25 pikë ishte shënuesi më i mirë për Portlandin, lider në parket. Befason Miami, që mundi 118-115 Utah Jazzin, një përballje mes dy ekipesh



pretendente në konferencat përkatëse. Mitchell realizoi 37 pikë për Jazzin, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Miamin u

Rezultatet

Denver - Houston	95-94
Miami - Utah Jazz	118-115
Chicago - Philadelphia	104-114
Dallas - Boston	107-104
Phoenix - Atlanta	121-117
Portland - Lakers	105-90

dalluan Herro me 29 pikë e Butleri me 27. Fitoi edhe Dallasi, që mundi 107-104 Bostonin, me Donqiqin që realizoi 33 pikë.

SHKURT

Shevchenko, trajner i Genoas

Andryi Shevchenko tashmë është zyrtarisht trajneri më i ri i skuadrës italiane Genoa. Ish-sulmuesi i Milanit ka nënshkruar kontratë trevjeçare me klubin deri më 2024 ku do të përfitojë dy milionë euro në sezon. Në pritje të shënimit zyrtar, Genoa dhe Sheva kanë shkëmbyer tashmë mesazhe të qarta në "Twitter". Në një postimi në "Twitter" me flamurin ukrainas të Genovas, trajneri i është përgjigjur me emoji kuqebull, mesazhe që llogariten si njoftim zyrtar për arritjen e marrëveshjes. Shevchenko së fundi ishte trajner i kombëtares ukrainase ku qëndroi për pesë vjet nga viti 2016 deri më 2021 pas përfundimit të kampanjës në Evropianin e verës që shkoi.

Leonardo: Messi me shumë në kombëtare se në PSG

Leo Messi është grumbulluar nga Argjentina për ndeshjet kualifikuese të botërorit pavarësisht prej dëmtimit. Drejtori sportiv i PSG-së nuk është aspak i kënaqur nga kjo situatë. "Nga momenti që ka ardhur këtu, në dy muajt e parë ka kaluar më shumë kohë në kombëtare se këtu", ka thënë braziliani. "Tani luan me kombëtaren pavarësisht prej problemit muskolor", ka deklaruar Leonardo.

Lampardi, trajner i Rashicës?

Ish-trajneri i Chelsea, Frank Lampard, mund të ulet te Norwichi, raporton "Daily Mail". 45-vjeçari u lirua nga detyrat e tij pavarësisht se e udhëhoqi Norwichin drejt fitores së parë të sezonit në Ligën Premierë të shtunën përmes një triumfi 2-1 ndaj Brentfordit. Edhe shtëpitë e basteve e kanë vendosur Lampardin favorit për punën e trajnerit te Norwichi, me legjendën e bluve dhe Anglisë që është ende i papunë pas shkarkimit të tij nga "Stamford Bridge" në fillim të këtij viti.

Saul Kanello, unifikon titujt në peshat e mesme

Boksieri meksikan Saul Kanello arriti t'i unifikojë titujt e peshave të mesme pasi që në sfidën e zhvilluar në Las Vegas mundi Kaleb Plantin me nokaut teknik në raundin e 11-të. Me këtë rast boksieri meksikan, përpos që bashkoi titujt e peshës së mesme në versionet IBE, VBA, VBC dhe VBO, Kanello u bë kampioni i gjashtë dhe i pari nga Meksiko që ka pronësi katër titujt në një kategori të boksit. Boksieri meksikan regjistroi fitoren e 57 në 60 përballjet e deritanishme, prej të cilave 39 i mbylli me nokaut teknik, ndërsa në karrierën e tij ka edhe një disfatë dhe dy barazime. Në anën tjetër, për Kaleb Plantin është disfata e parë në 22 luftëra të zhvilluara.

Onana rikthehet pas 9 muajsh tek Ajaxi

Pas nëntë muajsh pezullim për shkak të dopingut, portieri kamerunas Andre Onana rikthehet të grumbullohet me Ajaxin dhe shkak është bërë një emergjencë portierësh për trajnerin Ten Hag, që ka

momentalisht në dispozicion vetëm Remko Pasveer. Gardiani 25-vjeçar është në muajt e fundit të kontratës me holandezët dhe ka refuzuar rinovimin, ndaj fillimisht ishte menduar që të lihej te skuadra

e të rinjve deri në fund të sezonit, por emergjenca bëri që Ten Hag ta marrë në pankinë. Më 5 shkurt të vitit të kaluar, Onana rezultoi pozitiv ndaj substancës "furosemid", të cilën e kishte marrë duke

ngatërruar ilaçet e tij me të gruas dhe pavarësisht prej besimit të mirë, UEFA e dënoi me nëntë muaj pezullim nga aktiviteti. Gardiani 26-vjeçar është lidhur me një kalim tek Interi, pasi në Holandë janë të

bindur që ka firmosur tashmë me zikaltrit dhe do të transferohet në fund të sezonit, ku pritet ta marrë vendin e Handanoviqit, që me 37 vjet mbi supe po mendon tërheqjen.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 2 (dy vende pune)

Nr. ref: 06/2021

Kohëzgjatja e Kontratës: 6 muaj, me mundësi vazhdimi (Orar i Plotë, Zëvendësim i Pushimit të Lehonisë)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe Komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e rakimeve;
- Mirëmbanë dosjet e Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlihen me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe Shërbimit Profesional në përgjithësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të kryer Fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
 - Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
 - Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
 - Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjesi;
 - Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
 - Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
 - Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!


Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 05.11.2021 deri më 22.11.2021, ora 16:00.

Për informata shtesë mundë të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshepte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Fadile Rahmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qiriazi " Prizren.
- ▶ Teuta Binaku shpall të pavlefshme diplomë e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Ymer Aliu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "28 Nentori " Dragash.
- ▶ Neshat Elshani shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- ▶ Edona Kastrati shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Lumnije Bytyqi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Avdyl Frasherri " Prizren.
- ▶ Auto Taxi "Adnan Smajli" shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb: 70875373.
- ▶ Liridon Buqaj shpall te pavlefshme certifikaten shtetore shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ D.P.T "Selaci" shpalle te pavlefshme certifikaten e TVSH-se me numer :330438590.
- ▶ Ali Fanaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Bejtush Cimili shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore" Trepca" Stanterg.
- ▶ Gjem Memqaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Ferdane Bilalli shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore " Shmesi Ahmeti".
- ▶ Varis Rakaj shpall te pavlefshme deftesen e kl X shfmu " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arben Asllanaj shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Durim Neshati shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Burim Beka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Kadri Kadrijaj shpall te pavlefshme 4 deftesat dhe diplomën shmpt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Shkëlqim Beka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari.
- ▶ Blerim Ibrahim shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues